



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15780 Prot.

Lezhë, më 02 . 09 . 2020

V E N D I M

Nr 125 , Datë 01 / 09 / 2020

PËR

“PËR MIRATIMIN E SHEMBJES SË NDËRTESESË “KONVIKTI I SHKOLLËS SË MESME KOLIN GJOKA, ME KOORDINATA 41.778306N, 19.645981E”, QYTETI LEZHË, SI REZULTAT I DËMTIMIT NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, të nenit 57, të nenit 58 të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar dhe Aktit Nr. 09, date 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

V E N D O S I:

- 1- Miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesës së dëmtuar “Konvikti i Shkollës së Mesme Kolin Gjoka, Lagjia Besëlidhja, Rruga Kosova me koordinata 41.778306N, 19.645981E, në qytetin e Lezhës”, me adresë Ndërtesa Nr.20/1, Rruga Kosova, Lezhë qytet, Bashkia Lezhë dhe e identifikuar nga ASHK Lezhë me pasuritë me Nr. 4/18, në zonën kadastrale Zk.8632, e ndodhur në Lagjia Besëlidhja, Qyteti Lezhë, në pronësi të Bashkisë Lezhë sipas akt-ekspertizes së thelluar, e konfirmuar nga Instituti i Ndertimit, e cila është shprehur për prishje të detyruar pasi struktura e objektit nuk plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë dhe objekti përbën rrezik për jetën e banorëve, bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
- 3- Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Mjedisit, mbështesin Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit.
- 4- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për shembjen e objektit, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë. Ndërhyrja për shembjen e objektit bëhet në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Policisë së Shtetit.
- 5- Për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të kërkojë asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

- 6- Një kopje e këtij vendimi i njoftohet menjëherë, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.
- 7- Ngarkohen Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Policia Bashkiake, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Mjedisit, Drejtoria e Kujdesit Social e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Emergjencave Civile për zbatimin e këtij vendimi.
- 8- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
ERNEST RAKAJ

